

KOMENTE TË PËRGJITHSHME

Mbi raportin e monitorimit të MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME për tremujorin e tretë të vitit 2014

MISIONI.

Misioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme është si më poshtë:

“Forcimi dhe garantimi i rendit e sigurisë publike, individuale e komunitare do të perbeje angazhimin parësor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili është: "Tolerancë zero ndaj krimit". Lufta kundër krimit të organizuar e trafiqeve. Angazhimi në luftën kundër terrorizmit. Siguria rrugore. Decentralizimi dhe autonomia vendore nëpërmjet angazhimit maksimalisht në funksion të zgjerimit dhe thellimit të procesit të decentralizimit në dobi të zhvillimit dhe përmirësimit të jetës së komuniteteve. Reformimi i ekzekutivit qendror dhe administrata publike. Administrata publike do të forcohet e konsolidohet sipas principeve të shërbimit publik, mbi bazën e meritës dhe të performancës. Statusi i nëpunësit civil do të shtrihet në pjesën më të madhe të organeve të administratës publike. Shërbimi Kombëtar i Mbrojtjes Civile.”

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ministria e Punëve të Brendshme, për vitin 2014, administron dhe menaxhon fondet publike sipas shtatë programeve buxhetore të miratuara, e më konkretisht:

- Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrimi”
- Programi “Policia e Shtetit”
- Programi “Garda e Republikës”
- Programi “Prefekturat dhe funksionet e deleguaratë Pushtetit Vendor”
- Programi “Shërbimi i Gjendjes Civile”
- Programi “Menaxhimi i Rezervave të Shtetit”
- Programi “Emergjencat Civile”

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Ministria e Punëve të Brendshme mbi monitorimin e buxhetit për tremujorin e tretë të vitit 2014, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë ministri paraqitet si më poshtë:

	Emërtimi	Plani 2014	Fakti 2014	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% e realizimit
1.	Shpenzime Korente	17.423.598	12.029.098	92,3	96,9	69,0
1.1	Personeli	13.166.278	9.438.020	69,7	76,0	71,7
1.2	Operative	4.257.320	2.591.078	22,5	20,9	60,9
2	Shpenzime kapitale	1.462.588	359.456	7,7	2,9	24,6
2.1	Financim i brendshëm	1.254.295	223.982	6,6	1,8	17,9
2.2	Financim i huaj	208.293	135.474	1,1	1,1	65,0
3	SHUMA	18.886.186	12.388.554	100,0	99,8	65,6
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		27.863	0,0	0,2	
4	TOTALI	18.886.186	12.416.416	100,0	100,0	65,7

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek


Sikurse mund të konstatohet nga tabela e mësipërme, masa e realizimit 9-mujor të buxhetit të vitit 2014, kundrejt buxhetit vjetor të miratuar është 65.7 përqind. Realizimi i shpenzimeve të korente renditet në rreth 69%, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve paraqitet në nivelin mjaft të ulët prej 24.6 %, të planit vjetor. Ndër arsyet kryesore të këtyre vonesave sërish përmenden procesi i prokurimeve, i cili kërkon respektimin e një sërë afatesh, detajimi me vonesë i fondeve të shpenzimeve kapitale, të destinuara për prokurim, ngurtësimi i një pjese të këtyre fondeve nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, dhe Sipërmarrjes.

Ndarja e fondeve buxhetore sipas programeve, dhe realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale për çdo program buxhetor, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi i Programit	SHPENZIMET KORENTE			SHPENZIMET KAPITALE			% e realizimit total
	PLAN	FAKT	% F/P	PLAN	FAKT	% F/P	
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1.045.143	688.801	65,9	27.375	8.239	30,1	65,0
Policia e Shtetit	12.953.620	9.088.362	70,2	1.243.030	335.065	27,0	66,4
Garda e Republikës	1.201.474	887.609	73,9	85.057	0	0,0	69,0
Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara	609.109	400.635	65,8	10.000	1.928	19,3	65,0
Shërbimi i Gjendjes Civile	700.259	399.080	57,0	40.000	135	0,3	53,9
Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	115.445	65.146	56,4	6.000	3.866	64,4	56,8
Emergjencat Civile	798.548	499.465	62,5	51.126	10.222	20,0	60,0
TOTALI	17.423.598	12.029.098	69,0	1.462.588	359.456	24,6	65,6

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Shpenzimet faktike totale, për secilin program paraqiten në grafikun e mëposhtëm. Të dhënat paraqiten në mijë lek. Sipas të dhënave për realizimin e shpenzimeve për tremujorin e tretë të vitit 2014, konstatohet një realizim i mirë në terma relativë të shpenzimeve korente, që varion nga 56.4% për programin e Menaxhimit të Rezervave të Shtetit, deri në 73.9% për programin e Gardës së Republikës. Sikurse cituar edhe më sipër, realizimi i shpenzimeve kapitale, mbeten në nivele minimale, sidomos për programin e Gardës dhe të Gjendjes Civile, ndërkohë që në krahasim me dy tremujorët e parë konstatohet një përmirësim i performancës për programet e tjera buxhetore. Këto vonesa në realizimin e shpenzimeve kapitale ndikojnë negativisht në performancën e MPB-së.



Struktura e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar, buxhetit me ndryshime dhe fakti i realizimit për tremujorin e tretë të vitit 2014, paraqiten në tabelën mëposhtme:

Kodi	Emërtimi i Programit	Struktura e Shpenzimeve		
		Buxheti Fillestar	Plani me ndryshime	Shpenz. Faktike
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	4,9	5,7	5,6
03140	Policia e Shtetit	74,8	75,2	76,1
03150	Garda e Republikës	7,1	6,8	7,2
01160	Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara	3,3	3,3	3,2
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	4,3	3,9	3,2
01180	Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	0,6	0,6	0,6
10910	Emergjencat Civile	4,9	4,5	4,1
	TOTALI	4,9	5,7	5,6

Burimi: Ministria e Financave

Programi “Policia e Shtetit”, është programi më i madh buxhetor i MPB-së, dhe zë 76.1% të totalit të shpenzimeve faktike të kryera gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014. Më pas vjen programi “Garda e Republikës”, me rreth 7.2%, “Planifikim Menaxhimi” me 5.6%, “Emergjencat Civile” me 4.1%, “Gjendja Civile me 3.2%, “Pushteti Vendor” me 3.2% dhe në fund “Rezervat e Shtetit”, të cilat përbëjnë vetëm 0.6% të shpenzimeve totale të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Nga monitorimi konstatohet se struktura e shpenzimeve ndërmjet programeve në parashikimet sipas buxhetit fillestar dhe buxhetit me ndryshime, ka ndryshuar lehtësisht në thuajse të gjitha programet, me një shmangie të vogël nga vlera sipas planit fillestar vjetor.

PROGRAMET, PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE BUXHETORE.

Në vijim paraqitet një përshkrim i politikës së programeve buxhetore, objektivave dhe produkteve të tyre për vitin buxhetor 2014.

1. Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Ky program buxhetor, përgjithësisht përfshin shpenzimet për aparatin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe fondet e alokuara për këtë program buxhetor, përbëjnë rreth 5.7% të shpenzimeve totale të miratuara për MPB-në për vitin 2014. Ndërkohë, referuar të dhënave mbi shpenzimet faktike, rezulton se për tremujorin e tretë, shpenzimet për aparatin e MPB përbëjnë rreth 5.6% të shpenzimeve totale .

Për vitin 2014, **objektivat** e këtij programi buxhetor janë:

- Sigurimi i menaxhimit eficient dhe efektiv i burimeve financiare.
- Përmirësimi i shërbimeve funksionale të teknologjisë informacionit dhe komunikimit.
- Krijimi i standarteve për kuadrin ligjor, marrëveshje dhe projekte.
- Hartimi i Rregjistrit të Riskut dhe i strategjise së minimizimit të tij.
- Përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit

Për realizimin e këtyre objektivave, MPB ka alokuar rreth 1 miliardë lek lek në terma vjetorë, përfshirë dhe fondet e celura për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Në tremujorin e tretë të vitit 2014, **realizimi i planit të buxhetit** paraqitet në tabelën në vijim.

01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	1.045.143	688.801	97,4%	95,9%	65,9%
1.1	Personeli	479.983	308.035	44,8%	42,9%	64,2%
1.2	Operative	565.160	380.766	52,7%	53,0%	67,4%
2	Shpenzime kapitale	27.375	8.239	2,6%	1,1%	30,1%
2.1	Financim i brendshëm	27.375	8.239	2,6%	1,1%	30,1%
2.2	Financim i huaj	0	0	0,0%	0,0%	
3	SHUMA	1.072.518	697.040	100,0%	97,1%	65,0%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	21.122	0,0%	2,9%	
4	TOTALI	1.072.518	718.162	100,0%	100,0%	67,0%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse evidentohet edhe më sipër, shpenzimet korente përbëjnë rreth 97% të shpenzimeve të parashikuara në këtë program buxhetor, dhe brenda tyre vërehet se rreth 45% e fondeve të këtij programi shpenzohen për pagat e personelit të aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërkohë që pjesa tjetër shkon për shpenzimet e tjera operative. Shpenzimet kapitale, apo investimet publike zënë vetëm 2.6 të totalit të shpenzimeve të planifikuara të këtij programi, dhe vetëm 1.1 % të shpenzimeve faktike.

Më tej, për realizimin e objektivave buxhetore të sipërcituar, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), ka parashikuar 11 produkte buxhetore, nga të cilat janë realizuar plotësisht 9 produkte të parashikuara në planin e buxhetit të 9-mujorit të vitit 2014. Ndërkohë, janë realizuar pjesërisht produktet “Blerje pajisjesh”, dhe ”Objekt i Rikonstruktuar”. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programimit të fondeve buxhetore, rekomandojme përmirësimin e disa aspekteve që lidhen me emërtimin e produktit, njësinë matëse etj., për ti bërë ato më të matshme, dhe për të mundësuar lidhjen me objektivat e politikës së programit.

Në këtë program janë prezente edhe shpenzime nga ardhura jashtë limitit në vlerën 21.1 milion lek, të krijuara nga QKP Azilkërkuesit dhe Shtëpia e Pushimit Durrës.

2. Policia e Shtetit

Programi “Policia e Shtetit”, përbën programin më të madh buxhetor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe fondet e dedikuara për këtë program përbëjnë rreth 75% të buxhetit të miratuar për këtë institucion në vitin 2014.

Programi i Policisë së Shtetit përmban disa nën-programe ku përmendim **hetimi i krimeve, siguria publike, sigurimi i kufirit dhe migracionit dhe trajnimi policor**. Për secilin nga këto drejtime, Ministria e Punëve të Brendshme, parashikon objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre.

- Në drejtimin e hetimit të krimeve, programi synon të sigurojë një shërbim investigativ që realizon parandalimin, hetimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale nëpërmjet aplikimit të temave, metodave, teknikave speciale të hetimit, si dhe zbatimin e kërkesave ligjore që kanë të bëjnë me rritjen e sigurisë në vend, për paqe e një jetë më të mirë përqytetaret.
- Në drejtimin e sigurisë publike, programi synon të sigurojë rendin dhe qetesinë publike, nepermjet shërbimeve profesionale, në kohë dhe me cilësi si dhe të garantojë një mjedis të sigurtë për komunitetin e në partneritet me të, nepermjet policimit me standartet me të larta të performances.
- Në drejtimin e sigurimit të kufirit dhe migracionit, programi synon hartimin dhe zbatimin e politikave për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror duke bashkëpunuar me institucionet shqiptare dhe ato homologe të vendeve të tjera, në kuadër të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale.
- Në drejtimin e trajnimit policor, programi synon përfshirjen në trajnim në formë të ndryshme të gjithë personelit të policisë në përputhje me nevojat profesionale të organizatës, të njësisë ku bën pjesë punonjësi i policisë, funksionin, gradën, specialitetin dhe vlerësimin individual.

Për realizimin e këtyre qëllimeve, për vitin 2014, Ministria e Punëve të Brendshme ka alokuar në programin “Policia e Shtetit”, rreth 14.2 miliardë lek, në terma vjetorë, dhe në tremujorin e tretë të këtij viti, realizimi i planit të buxhetit paraqitet në tabelën në vijim.

03140	Policia e Shtetit	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	12.953.620	9.088.362	91,2%	96,4%	70,2%
1.1	Personeli	10.219.162	7.342.136	72,0%	77,9%	71,8%
1.2	Operative	2.734.458	1.746.225	19,3%	18,5%	63,9%
2	Shpenzime kapitale	1.243.030	335.065	8,8%	3,6%	27,0%
2.1	Financim i brendshëm	1.073.030	208.248	7,6%	2,2%	19,4%
2.2	Financim i huaj	170.000	126.817	1,2%	1,3%	74,6%
3	SHUMA	14.196.650	9.423.427	100,0%	99,9%	66,4%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	6.740	0,0%	0,1%	
4	TOTALI	14.196.650	9.430.167	100,0%	100,0%	66,4%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse evidentohet edhe nga tabela, shpenzimet korente përbëjnë rreth 91.2% të totalit të fondeve të planifikuara, ndërkohë që investimet janë në nivelin 8.8% të buxhetit. Më tej evidentohet se rreth 72% e fondeve buxhetore të alokuara për MPB-në në vitin 2014, planifikohet të shpenzohen për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të Policisë së Shtetit. Nëse konsiderojmë shpenzimet faktike, kjo panoramikë nuk paraqet ndryshime substanciale. Shpenzimet e personelit zënë rreth 77.9% të shpenzimeve faktike, ndërkohë, shpenzimet kapitale zënë rreth 3.6% të shpenzimeve faktike. Një konkluzion paraprak mund të nxirret lidhur me ecurinë e ngadaltë të shpenzimeve kapitale, edhe si pasojë e vonesave dhe procedurave të prokurimit.

Këto fonde buxhetore shpenzohen për realizimin e qëllimeve të sipërcituara, nëpërmjet 72 produkteve buxhetore. Më specifikisht, në tremujorin e tretë të vitit, evidentohet se 64 prej tyre janë realizuar plotësisht, dhe 6 pjesërisht, në raport me planin e periudhës përkatës, në terma vlere dhe sasie, dhe 2 produkte nuk janë realizuar. Në tërësi, konstatohet një performance e mirë realizimi për produktet të evidentuara në këtë program, ndërkohë MPB duhet të marrë masa për përmirësimin e emërtimit të produkteve buxhetore, në mënyrë që të mundësohet lidhja me objektivat e politikës së programit.

3. Garda e Republikës

Programi “Garda e Republikës”, përbën programin e dytë më të madh të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe fondet e dedikuara për këtë program përbëjnë rreth 6.8% të buxhetit të miratuar për MPB-në në vitin 2014.

Nëpërmjet fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë së personaliteteve vendas dhe të huaj, si dhe rritja e shkallës së sigurisë për objektet e rëndësisë së veçantë, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese, duke siguruar përputhje me standartet më të larta europiane në fushën e sigurisë së Personaliteteve të Larta Shtetërore.

Për vitin 2014, MPB ka alokuar rreth 1.28 miliardë lek në këtë program buxhetor, dhe realizimi i planit të buxhetit, për tremujorin e tretë të vitit 2014, paraqitet në tabelën në vijim.

03150	Garda e Republikës	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	1.201.474	887.609	93,4%	100,0%	73,9%
1.1	Personeli	995.000	754.841	77,3%	85,0%	75,9%
1.2	Operative	206.474	132.768	16,0%	15,0%	64,3%
2	Shpenzime kapitale	85.057	0	6,6%	0,0%	0,0%
2.1	Financim i brendshem	85.057	0	6,6%	0,0%	0,0%
2.2	Financim i huaj	0	0	0,0%	0,0%	#DIV/0!
3	SHUMA	1.286.531	887.609	100,0%	100,0%	69,0%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0,0%	0,0%	
4	TOTALI	1.286.531	887.609	100,0%	100,0%	69,0%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse evidentojmë nga tabela, edhe për këtë program buxhetor, shpenzimet e personelit planifikohet të zënë rreth 77.3% të fondeve totale të alokuara në terma të planit vjetor. Në të njëjtën kohë, ky zë përbën rreth 85% të shpenzimeve faktike të Gardës së Republikës. Një element që duhet të theksohet është fakti se shpenzimet kapitale janë në nivelin e vetëm 6.6% e totalit të shpenzimeve të planifikuara, vjetore, ndërkohë që edhe në tremujorin e tretë të vitit nuk është realizuar projekti i investimit për rikonstruksionin e Komandës së Gardës.

Në programin “Garda e Republikës”, janë parashikuar 2 produkte buxhetore, dhe më specifikisht “Ruajtja e personaliteteve të larta shtetërore, vendas dhe të huaj” i cili rezulton plotësisht i realizuar për periudhën e raportimit, si dhe produkti “Rikonstruksioni i Komandës së Gardës”, i i përmendur më sipër.

4. Prefekurat dhe Funksonet e Deleguara të Pushtetit Vendor

Fondet e alokuara për këtë program buxhetor, synojnë forcimin e rendit kushtetues, koordinimin e veprimtarive dhe kontributeve të institucioneve qendrore me ato vendore për një zhvillim lokal dhe rajonal të qëndrueshëm. Më tej, synohet zbatimi i programit të qeverisë nga institucionet qendrore në nivel lokal, përdorimin me efikasitet të fondeve buxhetore dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetareve. Gjithashtu, nëpërmjet Strukturave të Administrimit të Tokës në Qarqe, kryhet azhurnimi i sipërfaqeve të tokës, përgatitja e dokumentacionit dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e tokës në përputhje me strategjitë dhe planet e zhvillimit.

Për vitin 2014, fondet e dedikuara për këtë program përbëjnë rreth 3.3 % të buxhetit të miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe 3.2% të shpenzimeve faktike për tremujorin e tretë të vitit. Tabela në vijim paraqet realizimin e planit të buxhetit.

01160	Prefekurat dhe Funksonet e Deleguara të P. Vendor	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	609.109	400.635	98,4%	99,5%	65,8%
1.1	Personeli	459.500	304.384	74,2%	75,6%	66,2%
1.2	Operative	149.609	96.251	24,2%	23,9%	64,3%
2	Shpenzime kapitale	10.000	1.928	1,6%	0,5%	19,3%
2.1	Financim i brendshem	9.707	1.928	1,6%	0,5%	19,9%
2.2	Financim i huaj	293	0	0,0%	0,0%	0,0%
3	SHUMA	619.109	402.563	100,0%	100,0%	65,0%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0			
4	TOTALI	619.109	402.563	100,0%	100,0%	65,0%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse evidentohet nga tabela, shpenzimet korente zënë 98.4% të fondeve totale të planifikuara për vitin 2014, për këtë program, ky shpenzimet e personelit zënë pjesën kryesore, me 74% të shpenzimeve të planifikuara, dhe 75.6% të shpenzimeve faktike. Shpenzimet kapitale zënë vetëm 1.6% të fondit të alokuar për këtë program, dhe për periudhën 9-mujore, projekti i vetëm i investimit, me financim të brendshëm, për blerjen e pajisjeve është realizuar në nivele minimale, për arsye të afateve dhe procedurave të prokurimit.

Në programin “Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara të Pushtetit Vendor”, për vitin 2014, janë parashikuar 5 produkte, nga të cilët, sipas informacionit të përcjellë nga MPB, 4 janë realizuar plotësisht në raport me planin e periudhës, ndërkohë që produkti tjetër, për blerjen e pajisjeve për institucionet e Prefektit, rezulton i realizuar në nivele mjaft të ulëta, për arsyet e cituara më sipër.

5. Shërbimi i Gjendjes Civile

Programi buxhetor “Shërbimi i Gjendjes Civile”, siguron shërbimin e regjistrimit dhe përditësimit të të dhënave të shtetasve në Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile dhe në Regjistrin Kombëtar të Adresave. Informacioni i shërbimit të gjendjes civile është tërësia e të dhënave personale, që vërteton lindjen, ekzistencën, individualitetin e shtetasve, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Këto të dhëna shërbejnë për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në marrëdhëniet me shoqërinë e shtetit shqiptar, si dhe për ushtrimin e funksioneve të organeve dhe institucioneve shtetërore.

Për vitin 2014, objektivat e politikës së këtij programi janë:

- Mbajtja në mënyrë efektive dhe efçente e përditësimit të ngjarjeve në regjistrin civil
- Mirëfunksionimi efçient dhe i sigurtë i Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, zhvillimi dhe përmirësimi i moduleve të këtij sistemi dhe Sistemit Kombëtar të Adresave.
- Shfrytëzimi dhe garantimi i një sistemi efçient dhe të sigurtë për autorizimin dhe çertifikimin e aplikimeve për lëshimin e dokumentave të identitetit, letërnjoftimit dhe pasaportës.

Për vitin 2014, fondet e dedikuara për këtë program, prej 740 milion lek, përbëjnë rreth 3.9 % të buxhetit të miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe 3.2% të shpenzimeve faktike të MPB për tremujorin e tretë të vitit 2014. Realizimi i planit të buxhetit për këtë periudhë raportimi, paraqitet në tabelën në vijim.

Në mijë lek						
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	700.259	399.080	94,6%	100,0%	57,0%
1.1	Personeli	380.100	263.884	51,3%	66,1%	69,4%
1.2	Operative	320.159	135.197	43,2%	33,9%	42,2%
2	Shpenzime kapitale	40.000	135	5,4%	0,0%	0,3%
2.1	Financim i brendshëm	40.000	135	5,4%	0,0%	0,3%
2.2	Financim i huaj	0	0	0,0%	0,0%	
3	SHUMA	740.259	399.215	100,0%	100,0%	53,9%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0,0%	0,0%	
4	TOTALI	740.259	399.215	100,0%	100,0%	53,9%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse mund të konstatohet edhe nga tabela e mësipërme, ky program buxhetor paraqet një nivel realizimi të shpenzimeve prej 53.9% të planit vjetor, kryesisht prej nivelit të realizimit të shpenzimeve korente, ndërkohë që investimet rezultojnë të realizuar në masën 0.3% për periudhën referuese.

Në këtë program, janë parashikuar 4 produkte, nga të cilët 3 janë realizuar, ndërkohë që produkti i mirëmbajtjes së Regjistrisë Kombëtare të Adresave rezultoi i përcaktuar, si pasojë e ngrirjes së fondeve në pritje të miratimit të AKSHI-it, si projekte që lidhen me teknologjinë e informacionit, dhe janë në proces prokurimi.

6. **Menaxhimi i Rezervave të Shtetit**

Qëllimi i këtij programi është administrimi i stokut të mallrave rezervë materiale shtetërore, për t'u përdorur për të ndërhyrë në situatat në nevojë. Më tej, programi administron edhe mallrat e sekuestruara, konfiskuara, mallra të lëna në ruajtje etj., nëpërmjet Drejtorive Rajonale të shtrira në të gjithë territorin e vendit.

Për vitin 2014, fondet e dedikuara për këtë program përbëjnë rreth 0.6 % të buxhetit të miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme. Tabela në vijim paraqet realizimin e planit të buxhetit, për këtë program deri në nëntë muajt e tretë të këtij viti.

01180	Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	115.445	65.146	95,1%	94,4%	56,4%
1.1	Personeli	71.527	50.088	58,9%	72,6%	70,0%
1.2	Operative	43.918	15.058	36,2%	21,8%	34,3%
2	Shpenzime kapitale	6.000	3.866	4,9%	5,6%	64,4%
2.1	Financim i brendshëm	6.000	3.866	4,9%	5,6%	64,4%
2.2	Financim i huaj	0	0	0,0%	0,0%	
3	SHUMA	121.445	69.012	100,0%	100,0%	56,8%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0,0%	0,0%	
4	TOTALI	121.445	69.012	100,0%	100,0%	56,8%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse evidentohet më sipër, shpenzimet korente përbëjnë 95% të fondeve të planifikuara në këtë program buxhetor, dhe 94.4% të shpenzimeve faktike për periudhën e 9-mujorit. Rrjedhimisht shpenzimet kapitale janë realizuar në vetëm 5.6 % të planit vjetor. Në total, niveli i realizimit të shpenzimeve buxhetore për këtë program është rreth 56.8% të planit vjetor. Ministria e Punëve të Brendshme duhet të marrë masat për një planifikim dhe shpërndarje më të mirë të fondeve buxhetore për këtë program.

Me fondet buxhetore të vëna në dispozicion nga Ministria e Punëve të Brendshme, për programin “Menaxhimi i Rezervave të Shtetit”, janë planifikuar 6 produkte buxhetore të cilat rezultojnë të realizuara pjesërisht në terma vlere dhe sasie.

7. Emergjencat Civile

Programi buxhetor “Emergjencat Civile”, zhvillon politika dhe strategji në fushën e menaxhimit të situatave të emergjencave civile”, duke bashkërenduar veprimet e të gjitha strukturave shtetërore, në mënyrë që të reduktojë në mënyre substanciale humbjet në njerëz, asete sociale, në ekonomi dhe mjedis. Institucionet e këtij programi buxhetor, vlerësojnë rreziqet dhe dëmet e shkaktuara nga fatkëqesi të ndryshme, si dhe programojnë kontrollonë masa paraprake, parandaluese, mbrojtëse dhe reaguese.

Për vitin 2014, fondet e alokuara për këtë program, prej rreth 849 milion lek, përbëjnë 5 % të buxhetit të miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe 4.1% të shpenzimeve faktike për periudhën 9-mujore. Tabela në vijim paraqet realizimin e planit të buxhetit, për këtë program deri në tremujorin e tretë të këtij viti.

10910	Emergjencat Civile	Plani	Fakti	Plani/ Totalin	Fakti/ Totalin	% realizimi
1.	Shpenzime Korente	798.548	499.465	94,0%	98,0%	62,5%
1.1	Personeli	561.006	414.652	66,0%	81,4%	73,9%
1.2	Operative	237.542	84.813	28,0%	16,6%	35,7%
2	Shpenzime kapitale	51.126	10.222	6,0%	2,0%	20,0%
2.1	Financim i brendshëm	13.126	1.565	1,5%	0,3%	11,9%
2.2	Financim i huaj	38.000	8.657	4,5%	1,7%	22,8%
3	SHUMA	849.674	509.687	100,0%	100,0%	60,0%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	0	0	0,0%	0,0%	
4	TOTALI	849.674	509.687	100,0%	100,0%	60,0%

Burimi: Ministria e Financave, të dhënat në mijë lek

Sikurse evidentohet më sipër, shpenzimet korente përbëjnë 94% të fondeve totale të alokuara për këtë program buxhetor dhe mes tyre, 66% janë shpenzime për personelin, dhe vetëm 28 janë shpenzimet operative për përballimin e nevojave të institucionit dhe të situatave të emergjencës që mund të paraqiten për vitin 2014. Shpenzimet kapitale përbëjnë 6% të fondeve të alokuara dhe vetëm 2 % të shpenzimeve faktike deri në tremujorin e tretë. Në total, niveli i realizimit të buxhetit në 60% sërish evidenton ngadalësinë në realizimin e projekteve të investimeve.

Për këtë program buxhetor në vitin 2014, janë parashikuar 8 produkte buxhetore, nga të cilat 6 rezultojnë të realizuara plotësisht për planin e periudhës, 1 produkt është realizuar pjesërisht, dhe produkti që lidhet me ndihmesën financiare për shtetasit të cilëve u janë dëmtuar banesat, dokumentat janë ende në fazën e shqyrtimit, e për rrjedhojë ky produkt rezulton i parealizuar për periudhën e 9-mujorit.

KRAHASIMI I TË DHËNAVE FAKTIKE

Tabela në vijim, paraqet krahasimin e të dhënave faktike, të përmbajtura në raportin e monitorimit të hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme me të dhënat mbi shpenzimet faktike të sistemit të Thesarit, për periudhën raportuese të 9-mujorit.

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	MPB	MF	Dif	MPB	MF	Dif	MPB	MF	Dif
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	688.801	688.801	0	8.239	8.239	0	697.040	697.040	0
Policia e Shtetit	9.088.362	9.088.362	0	335.065	335.065	0	9.423.427	9.423.427	0
Garda e Republikës	887.609	887.609	0	0	0	0	887.609	887.609	0
Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara	400.635	400.635	0	1.928	1.928	0	402.563	402.563	0
Shërbimi i Gjendjes Civile	399.080	399.080	0	135	135	0	399.215	399.215	0
Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	65.146	65.146	0	3.866	3.866	0	69.012	69.012	0
Emergjencat Civile	499.465	499.465	0	10.222	10.222	0	509.687	509.687	0
Totali i Shpenzimeve	12.029.098	12.029.098	0	359.456		0	12.388.554	12.388.554	0
<i>Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit</i>							27.863	27.863	0
Totali i Shpenzimeve të Ministrisë							12.416.416	12.416.416	0

Burimi: Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, të dhënat në mijë lek

Ashtu sikurse paraqitur në tabelën e mësipërme, të dhënat faktike e përdorura nga Ministria e Punëve të Brendshme për përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për tremujorin e tretë të vitit 2014, përputhen plotësisht me të dhënat e nxjerra nga sistemi informatik financiar i qeverisë.

KOMENTE TË TJERA

- Duke vlerësuar përpjekjet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, sjellim në vëmendje që në raportin e monitorimit, duhet të përfshihet më tepër informacion mbi realizimin e produkteve të programeve buxhetore, të cilat gjithashtu duhet të jenë të lidhura edhe me realizimin e objektivave të politikës së programit.
- Gjithashtu, kërkohen më tepër përpjekje në drejtim të përmirësimit të objektivave dhe produkteve buxhetore, emërtimeve të tyre dhe njësive matëse mbi bazën e të cilave monitorohet performanca e përdorimit të burimeve financiare publike.
- Të harmonizohet dhe saktësohet informacioni i paraqitur në dokumentin e raportit të monitorimit dhe informacioni i paraqitur në tabelat dhe anekset shoqëruese lidhur me statusin e realizimit të produkteve buxhetore.

PUBLIKIMI NË FAQEN E INTERNETIT

Ministria e Punëve të Brendshme ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportin e monitorimit të buxhetit për tremujorin e tretë të vitit 2014.